



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.691/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rrustem Thaçi kryesues, Faton Ademi dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatës për Kuvend Komunal Shkurte Mustafa nga radhët e Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Shtime, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 20.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e palejuar ankesa Anr.691/2021 e datës 19.10.2021, e paraqitur nga kandidatja për Kuvend Komunal Shkurte Mustafa nga radhët e Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Shtime, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 19.10.2021, ka pranuar një ankesë Anr.691/2021 nga Shkurte Mustafa kandidatë për Kuvend Komunal në Shtime nga radhët e Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, në të cilën theksohet se pasi që ka përfunduar procesi i votimit në vendvotimin me nr. 2206/03R, gjatë numërimit të fletëvotimeve është bërë një gabim i cili nuk përputhet, votat e kandidatës Shkurte Mustafa gjatë bartjes nga FLLK në FRP janë shënuar 60 vota më pak në FRP, për këtë kam dëshmi edhe FLLK dhe FRP.

Si dëshmi ka bashkangjitur edhe deklaratën kryesuesit të vendvotimi Adnan Gashi dhe anëtareve të vendvotimit .

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsitë në vendvotimin me nr. 2206/03R, për faktin se gabimet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrihen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankueses. Hudhja e ankesës së Shkurte Mustafa nuk e paragjykon çështjen dhe ankueses nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.691/2021 më datën 20.10.2021

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*

